



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra


Swiss Cooperation for Development
and Cooperation SDC



United Nations
ALBANIA



TË RINJTË BASHKIA E DURRËSIT



Qershor 2018



Leave
No One
Behind



Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky Publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Rr. "Blv. Bajram Curri" Nd. 136, H. 14, Ap. 1

Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00355 42 258 987

Email: info@observator.org.al

Webmail: www.observator.org.al

Ky Publikim është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

Përmbytja e këtij Publikimi është përgjegjësi e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në emër të rrjetit të organizatave "Zëri i të rinjve". Opinione të shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së, UN Albania apo SDC.

Në periudhën Prill - Maj 2018 janë anketuar 100 të rinj nga Bashkia e Durrësit me qëllim matjen e njohurive të tyre mbi:

- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs)
- Shëndetin Seksual dhe Riprodhues
- Programet dhe shërbimet e Bashkisë për të rinjtë

PROFILI I TË RINJVE TË ANKETUAR:

• **Grupmosha:** 14 - 29 vjeç

• **Vendndodhja:**

50% nga zonat urbane

- Universiteti "Aleksandër Moisiu" (Curila)

- Universiteti "Aleksandër Moisiu" (Kampusi i ri)


- Gjimnazi "Leonik Tomeo"

- Shkolla 9 vjeçare "Qemal Mici"

50% nga zonat rurale

- Shkolla e Bashkuar, Kullë

- Shkolla "Njazi Mastori", Sukth



71 përqind
e të rinjve të anketuar janë
vajza

FAKTE MBI TË RINJTË E DURRËSIT

A. NJOHURITË MBI OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË
QËNDRUESHËM (SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS - SDGs)




1 në 6

të rinj kanë dëgjuar se çfarë janë SDGs

Ndërmjet të rinjve që kanë njohuri mbi SDGs, **interneti është burimi më i shpeshtë i informacionit** për të rinjtë në zonat urbane (50%) dhe rurale (80%) për pasurimin e njohurive të tyre mbi këtë çështje.

Shkolla dhe organizatat e shoqërisë civile janë gjithashtu burime për marrjen e informacionit mbi SDGs nga të rinjtë.

Ndërsa institucionet lokale dhe familja në asnjë rast nuk janë cituar si burime informacioni mbi SDGs nga të rinjtë e anketuar në zonat urbane dhe rurale.




ANGAZHIMI I TË RINJVE NË ARRITJEN E SDGs

Të rinjtë janë pyetur në lidhje me angazhimin personal dhe përfshirjen në aktivitete të ndryshme mbi SDGs.

Shumica e të rinjve të grupmoshave të ndryshme **(66% e rasteve)** janë shprehur se nuk janë përfshirë personalisht në arritjen e SDGs. Vetëm 14% e të rinjve shprehen se janë përfshirë pjesërisht në arritjen e SDGs.

7% e të rinjve të grupmoshës 24 – 29 vjeç dëshirojnë të përfshihen, por nuk kanë informacionin e nevojshëm se si mund të ndodh kjo gjë.

Përqindja e të rinjve të përfshirë personalisht në arritjen e SDGs



Të rinjtë janë pyetur edhe mbi rolin që ata mendojnë se mund të kenë për arritjen e SDGs.



ROLI i të RINJVE në arritjen e SDGs (sipas të rinjve të anketuar)

- Rol ndërlidhës mes institucioneve dhe qytetarëve;
- Ndërgjegjësim i shoqërisë dhe bashkëmoshatarëve për çështjet prioritare të të rinjve;
- Agjent ndryshimi dhe motor i zhvillimit të një shoqërie nëpërmjet vullnetarizmit dhe përfshirjes.


FAKTE MBITË RINJTË E DURRËSIT

B. NJOHURITË MBI SHËNDETIN SEKSUAL DHE RIPODHUES

Të rinjtë janë pyetur edhe mbi njohuritë e tyre në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues.

Pjesa më e madhe e të rinjve të anketuar kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues. Anketimi tregoi se **1 në 11** të rinj nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues. 7% e të rinjve që kanë pohuar se nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues apo nuk i janë përgjigjur pyetjes, i përkasin zonave rurale. Ndër të rinjtë më të informuar janë vajzat në zonat urbane (37%) dhe të rinjtë më pak të informuar janë djemtë në zonat rurale (12%).


Përqindja e të rinjve që kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues




Ndërmjet të rinjve që kanë njohuri mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, **shkolla dhe interneti janë burimi më i shpeshtë i informacionit të përdorur** për pasurimin e njohurive të të rinjve mbi këtë çështje.

Ndërsa **shkolla, interneti, trajnimet, media dhe bashkëmoshatarët konsiderohen mjetet ideale për marrjen e informacionit** për shëndetin seksual dhe riprodhues nga ana e të rinjve.

Burimet e informacionit



Përqindja e të rinjve që i'u është folur në shkollë për:




Shumica e të rinjve (37%) shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është pjesërisht i mjaftueshëm.

Interesante është rezultati mbi 23% e të rinjve në zonat rurale që shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është i mjaftueshëm, pëkundrejt 8% e të rinjve në zonat urbane që shprehen se informacioni i marrë në shkollë është i mjaftueshëm.

Nga analiza gjinore rezulton se janë kryesisht vajzat (në zonat urbane dhe rurale) ato që shprehen se informacioni i marrë në shkollë është i mjaftueshëm ose i pamjaftueshëm. Shumica e djemve përgjigjen pjesërisht ose nuk e di.

A është i mjaftueshëm informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues?




Nga anketimi i të rinjve në Durrës, rezultoi se shumica e tyre **(60% në zonat urbane dhe 38% në zonat rurale)** nuk flasin me prindërit e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues.

Vetëm **24% e të rinjve të anketuar në zonat urbane** pohojnë se flasin me prindërit e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues, ndërsa në zonat rurale kjo shifër është 0%, pra të gjithë të rinjtë e anketuar në zonat rurale shprehen se nuk komunikojnë me prindërit për këtë tematikë.

Në radhët e të rinjve që flasin mbi këtë tematikë, rezulton se asnjë prej tyre nuk komunikon me babain, në një pjesë të rasteve të rinjtë preferojnë të komunikojnë mbi këtë tematikë me më shumë sesa një person, psh me nënën, me shokët dhe mësuesit/et.

Interesante është rezultati i **2% e të rinjve në zonat urbane dhe 2% e të rinjve në zonat rurale** që shprehen se **prindërit nuk i lejojnë** të komunikojnë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues në familjet e tyre. Kjo e dhënë hedh dritë mbi një punë më të madhe që duhet bërë mbi këtë tematikë edhe me kategorinë e prindërve.

A flisni për shëndetin riprodhues dhe seksual me prindërit tuaj?




FAKTE MBITË RINJTË E DURRËSIT

C. NJOHURITË MBI PROGRAMET DHE SHËRBBIMET E BASHKISË PËR TË RINJTË

1 në 5 të rinj janë në dijeni të programeve/ prioriteteve të Bashkisë në lidhje me të rinjtë. Ndër të rinjtë që janë shprehur se janë në dijeni të programeve që ofron Bashkia e Durrësit, vajzat e zonave rurale (45%) janë më të informuara në lidhje me këto shërbime, ndërsa grupi më pak i informuar janë djemtë nga zonat urbane (15%) dhe rurale (15%).



Shumica e të rinjve (64% në zonat urbane dhe 82% në zonat rurale) **nuk kanë marrë ndonjëherë pjesë në takime** që Bashkia ka zhvilluar me të rinjtë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të zonës.



16% e të rinjve nga zonat urbane dhe 4% e të rinjve nga zonat rurale janë shprehur se kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga Bashkia (Ndonjëherë ose shpesh).


Nga të rinjtë që janë informuar mbi programet e Bashkisë, rezulton se mjeti më i përdorur për marrjen e informacionit nga Bashkia janë:

a. Njoftimet publike (16%) - për të rinjtë në zonat rurale

b. Portali online (20%) – për të rinjtë në zonat urbane

Broshurat dhe faqja zyrtare e Bashkisë mbeten gjithashtu mjete informuese të përdorura nga të rinjtë.


Ndërsa Buletini informativ është mjeti informues mbi aktivitetet dhe veprimtarinë e Bashkisë që nuk përdoret nga të rinjtë e zonave urbane dhe rurale.



Ofrimi i mjediseve të gjelbërta dhe takimet e vazhdueshme informuese

janë programet më të preferuara që të rinjtë do të donin të përfitonin nga Bashkia e Durrësit. Gjithashtu të rinjtë kanë identifikuar si shërbime të preferuara edhe punësimin, përfshirjen në vendimmarrje si edhe ofrimin e bazës materiale në shkolla.


Përqindja e të rinjve që do të donin që Bashkia të ofronte shërbimet e mëposhtme për të rinjtë



Vetëm 5 % e të rinjve vlerësojnë shumë mirë ofrimin e shërbimeve administrative të Bashkisë në përputhje me nevojat e të rinjve, ndërsa 8% e të rinjve vlerësojnë maksimalisht ngritjen dhe funksionimin e zyrave me një ndalesë në Bashki.

Përqindja e të rinjve të cilët vlerësojnë me pikët më poshtë shërbimet që janë ofruar nga Bashkia për të rinjtë

(1- vlera më e vogël, 5- vlera më e madhe)



TË RINJTË BASHKIA E DURRËSIT

